



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
KRYETARI

Nr. 492 prot
1

Tiranë, më 29.03.2021

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 63, datë 29.03.2021

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS
TË RISHIKUAR TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 5, nenit 6 dhe nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” urdhrin të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr.187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, urdhrin të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr.188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”, në cilësinë e titullarit të Komisionit të Prokurimit Publik

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me urdhrin e KDIMDP nr.187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, bashkëlidhur.
2. Miratimin e Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar, sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me urdhrin e KDIMDP nr.188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”, bashkëlidhur.
3. Ngarkohen të gjitha strukturat dhe koordinatori për të drejtën e informimit, për të bashkërenduar punën për bërjen publike sa herë që është e domosdoshme, të çdo dokumenti, në funksion të programit të transparencës të rishikuar.
4. Programi i Transparencës së Komisionit të Prokurimit Publik, miratuar me urdhrin nr.1012, datë 26.05.2017 shfuqizohet.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

